



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Durrës  
KËSHILLI I BASHKISË

**VENDIM**

Nr. 24, datë 29.04.2020

**PËR  
MIRATIMIN E NGRITJES SË QENDRËS PËR SHËRBIME MBROJTËSE,  
FUQIZUESE DHE EMERGJENTE PËR FËMIJËN DHE FAMILJEN, SI DHE  
PËRDORIMIN E FONDIT PREJ 5'421'264 LEKË, TË AKORDUAR NGA  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr. 88/2019, datë 18.12.2019 "Për buxhetin e vitit 2020", Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve", Ligjit nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", VKB nr. 419, datë 03.04.2017 "Për miratimin e planit social dhe planit të përfshirjes sociale të Bashkisë Durrës", Marrëveshjes së bashkëpunimit me Fondacionin World Vision Albania nr.16916 prot, datë 11.11.2019, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, me propozim të Zëvendëskryetares Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e ngritjes së Qendrës për shërbime mbrojtëse, fuqizuese dhe emergjente për fëmijën dhe familjen me strukturën prej 6 (gjashtë) punonjësish si më poshtë vijon:

Nr. Rend.	Emërtimi i Pozicionit	Numri i punonjësve	Klasa	Shtesa për pozicion
1.	Drejtores ekzekutive	1 (një)	IIIa-1	53'280 Lekë

2.	Psikolog	1 (një)	III-B	40'430 Lekë
3.	Punonjëse sociale	2 (dy)	III-B	40'430 Lekë
4.	Shofer	1 (një)	--	28'600 Lekë
5.	Punonjëse pastrimi/guzhinë	1 (një)	--	28'600 Lekë

2. Miratimin e përdorimit të fondit prej 5'421'264 lekë, të akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale për ngritjen e Qendrës, që do të ofrojë shërbime mbrojtëse, fuqizuese dhe emergjente për fëmijën dhe familjen, ndarë si mëposhtë vijon:

-	Zëri	600	me vlerë	4'422'840 Lekë
-	Zëri	601	me vlerë	638'424 Lekë
-	Zëri	602	me vlerë	360'000 Lekë


3. Veprimet financiare të kësaj Qendre do të kryhen nga nëpunësi zbatues i nivelit të dytë pranë Qendrës Ditore të Moshuarve.

4. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Durrës për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

Ani Dyrmishi




**U shpall sot me datë 29/ 04 / 2020**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 335 Prot.

Durrës, më 30.04.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓  
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 24, datë 29.04.2020 "Për miratimin e ngritjes së Qendrës për shërbime mbrojtëse, fuqizuese dhe emergjente për fëmijën dhe familjen, si dhe përdorimin e fondit prej 5'421'264 lekë, të akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që më jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

